

V E N D I M
Nr.522, datë 1.11.1993

**PËR PËRJASHTIMIN NGA PAGESA PËR SHËRBIMET MJEKËSORE TË SHTETASVE TË
HUAJ QË DIAGNOSTIKOHEN MË SËMUNDJE NGJITËSE**

Me propozim të Ministrisë së Shëndetësisë dhe të Mbrojtjes së Mjedisit, Këshilli i Ministrave,

V E N D O S I:

1. Të përjashtohen nga pagesa për shërbimet mjekësore shtetasit e huaj të sëmurë që diagnostikohen me sëmundje ngjitëse dhe që detyrimisht duhet të shtrohen (izolohen) në spital.

Në këtë kategori të përfshihen të sëmurët me sëmundjet e konventës (kolera, murtaja, ethet e verdha), si dhe me malarje, sifilis, tifo e zorrëve, tifo e morrit dhe legionelozis.

2. Fondet për shpenzimet e mjekimit të përballohen nga Ministria e Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes së Mjedisit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi